

## **PROCESVERBAL - Tipi i kontratës-PUNË**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mbrojtje lumore në fshatin Arrëz, Bashkia Dimal”**

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45112000-5, 45243510-0, 45262340-6, 45262370-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 53 293 308 , 33** (pesëdhjetë e tre million e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e tetë presje tridhjetë e tre ) **Lekë pa TVSH**

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c.*Formulari i ofertes sipas Shtojce 1*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPPdhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

##### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

###### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 7 te DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet nëNenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

###### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- 2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020,2021,2022) të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te

miratuar, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.2 Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020,2021,2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se **53 293 309 leke.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave Të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur - Mbi kufirin e lartë monetar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma “a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” është përcaktuar jo më e vogël se vlera e kontratës për të rritur numrin e konkurrentëve në procedurë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike,

*kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e kërkesës për detyrimet vendore është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoritetet vendore nëpërmjet Vendimeve të Këshillave Bashkiak

**Shenim:** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Vërtetim ky që në fazën e ofertimit do të pranohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetdeklarimit. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik

2.2.4 Vërtetim qe nuk ka detyrime te cfardolloy natyre prane Autoritetit Kontraktor **Bashkia Dimal.**

**Argumentim:Vendosja e këtij kriteri i** sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori disponon kapacitete te mjaftueshme financiare për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzoje pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme.

Bazuar në ligjin “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

***Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

***Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:***

- Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore për këtë situacion;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Certifikatën e marrjes në dorezim të perkohshëm dhe/ose përfundimtar.
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Certifikatën e marrjes në dorezim/ Certifikatën e Perkohshme të marrjes në dorezim;
  - Faturat tatimore perkatese.

*Ne rast të BOE, Pika 1/a plotësohet nga anëtarët e bashkimit të përcaktuar në bashkim. Anëtarët e tjerët të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Shenim:** Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet edhe kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

**2.3.2** Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

#### **PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI**

- N.P –1 A (Punimegërmiminëtokë)
- NP - 9 C (Punime per mbrojtjelumore, sistemimehidraulikedhebonifikime)

#### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

- N.S – 18 B (Punimetopogjeodezike)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, I shoqeruar me dokumentat:

- Libreze pune;
- Kontrate pune e vlefshme;
- Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nëni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane

**Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.

- 2.3.4 Një punësim mesatar të paktën **75 (shtatdhejt e pese)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
- a. Vërtetimet të lëshuara nga Administrata Tatimore për minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit të deklaruar.
  - b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislativi në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

**Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.

- 2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenepjese të stafiteknik –inxhinierik të figurojë në Licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, libere pune si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi ( Jo i dypunësuar)
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

- 2.3.6 Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. **(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të disponojë 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e**

**shendetit në punë”, sipas zerave të punimeve/ sherbimeve / mallit që do të marre persiper të realizoje sipas akt marrevshjes).**

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 6 (gjashte) manovrator dhe 6 (gjashte) shofere, për të cilët duhet të paraqitet kontrata individuale e punës e vlefshme, Deshmi e Aftesise Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf mbeshtetes per kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetore, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Teknik ndertimi	2 (dy)
Saldator	2 (dy)
Hekurkthyes	2 (dy)
Karpentier	4 (kater)
Murator	4 (kater)

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet të plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucionipublik/privatleshuesicertifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				
2				
.....				
..				

\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit (**pervec tableles se mesiperme e cila duhet të paraqitet e plotesuar gjate fazes se ofertimit**), sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

*Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 mujorin e fundit 2023, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi*

i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 75 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e struktues se kostos (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth **20% te kostos**.

Kërkesa e mësipërme për 1 (një) punonjës me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëlidhur:

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zerave të preventivit (bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit si edhe analizën e çmimeve për çdo ze të preventivit. Mosparaqitja e tyre në formën e kërkuar përben shkak për skualifikim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**Ky kriter vendoset me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë shpërndarja e fuqisë puntore dhe e mjeteve me anë të një grafiku punimesh.**

2.3.10 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë 1 (një) punonjës me çertifikatë/ ose çertifikatë trajnimi si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” të lëshuara nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.



### **Argumentimi:**

2.3.11 Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) ekspert zjarrfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH.

- Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :
- kontratën individuale të punës;
- certifikatë/dëshmi kualifikimi.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

*Kërkesat e mësipërme mbështeten në Ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe Ligjit nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".*

*Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.*

*Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.*

*Kërkesa e mësipërme për 1 (një) ekspert zjarrfikës është përcaktuar bazuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 4 si dhe në VKM-në nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 39, pika 6/c. në Ligjin Nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” Kjo kërkesë vendoset referuar zërave të punimeve elektrike dhe mekanike. Gjithashtu, referuar dhe të dhënave të projektit si dhe specifikave teknike, personi përgjegjës për, duhet të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, të informojë dhe këshillojë stafin teknik dhe profesionalë*

2.3.12 Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin **1 (një) mjek** të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- a) kontratën e individuale të punës,
- b) diplomën universitare.
- c) licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

**Argumentim** : Kërkesa për mjekun e shoqërisë është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 692 datë 13.12.2001, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, neni 12/2 që parashikon shprehimisht se, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

2.3.13 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

<b>Makineri dhe pajisje</b>	<b>Nr.</b>	<b>Njesia</b>	<b>Gjendja</b>
Kamion vetshkarkues me kapacitet jo me te vogel 10 t	5	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion vetshkarkues me kapacitet jo me te vogel 20 t	4	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 t	4	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir jo me pak se 80 t	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir krahe gjate jo me pak se 25 m	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Dumper kantieri	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me goma	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Minieskavator / bobkat	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Buldozer	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Rul ngjeshes cilindrik me dhembe	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Autovinc mbi 250 t	1	cope	Ne pronesi ose me qera
RTV - Trasportier per mjete te renda	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Impiant Prodhim Inertesh me Leje Mjedisi tipi B	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Impiant Prodhim Betoni me Leje Mjedisi tipi B	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Moto gjenerator	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Saldatrice	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Betoniere kantieri	4	cope	Ne pronesi ose me qera
Vibrues betoni	5	cope	Ne pronesi ose me qera
Karoca dore	10	cope	Ne pronesi ose me qera
Betoforma	300	m2	Ne pronesi ose me qera
Moto pompe uji	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Kethyese hekuri / bango hekuri	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Kokore	57	cope	Ne pronesi ose me qera
Jelek	57	cope	Ne pronesi ose me qera
Tabela sinjalizuese kantieri	8	cope	Ne pronesi ose me qera
Komplet i ndihmes se shpejte	2	cope	Ne pronesi ose me qera

\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:*

a) Për mjetet në pronësi, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Leje trasporti (leshuar nga pushteti vendor e vlefshme)

b) Për mjetet e marra me qera, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj (e vlefshme).
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Leje trasporti per vete dhe te trete (leshuar nga pushteti vendor e vlefshme)

*Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.*

*Ne rast se operatori ekonomik nuk disponon mjet RTV – Transportues per mjetet e renda mund te paraqese kontrate bashkepunimi te vlefshme per gjithe periudhen qe zgjasin punimet.*

*Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te saktësisese informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do te konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim i hetimit administrativ për perjashtim të Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për

miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara në pronësi ose me qira.

.Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës dëshmon se mjetet, stafi Teknik dhe specialistet e deklaruara në formularin e vetedeklarimit sipas Shtojcës 8, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat e shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Dimal. Gjithashtu duhet të deklarojë vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim të verifikimit nga Autoriteti Kontraktor. Në rast deklarimi të rremë, do të veprohet në përputhje të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik“:

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- a) Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose **ekuivalente** lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- b) Certifikatë **OHSAS 18001-2007** mbi “Shëndetin dhe Sigurimin në punë”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim dhe/ose certifikatën **ekuivalente** të njohur nga standardet shqiptare **ISO 45001 – 2018**.
- c) Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, ose **ekuivalente** lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi

*kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

*Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 44/1 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: „Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

d)Leje Mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve”**me Kod III.2.B.**

**Argumentim:** *Ne mbeshtetje te ligjit nr.10448, date 14.07.2011 ”Per lejet e mjedisit”, Ligji nr. 10463, date 22.09.2011 ”Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” te nryshuar si dhe VKM nr. 538, date 26.05.2009 ”Per licensat dhe lejet”*

2.4.2 Operatori ekonomik ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne DST, duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë si më poshtë:

- a) Nyje Inerte
- b) Nyje Betoni
- c) Hekur
- d) Rjete teli e zinguar

*Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.*

**Argumentimi.** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre.

Paraqitja e autorizimit te prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave qe do te ofertoohen, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo

marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.